



# TRANSPAROMETRI KOMUNAL

Deçan

Gjakovë

Prizren

Prishtinë

Graçanicë

Gjilan



PRISHTINË, PRIZREN, GJAKOVË, GJILAN, DEÇAN, GRAÇANICË  
JANAR – DHJETOR 2016

SHKURT 2017, PRISHTINË





# TRANSPAROMETRI KOMUNAL

PRISHTINË, PRIZREN, GJAKOVË,  
GJILAN, DEÇAN, GRAÇANICË  
JANAR – DHJETOR 2016

SHKURT 2017, PRISHTINË

COPYRIGHT © 2016. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jo-komerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,  
10000, Prishtinë, Kosovë.  
Tel.: +381 (0)38 248 038  
E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
Web: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Përgaditur nga: Naim Cahanaj

Me asistencë hulumtuese nga: QendresaHamzaj

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS). Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

# PËRMBAJTJA

<b>HYRJE .....</b>	<b>6</b>
<b>METODOLOGJIA.....</b>	<b>7</b>
<b>RËNDËSIA DHE VLERËSIMI I INDIKATORËVE .....</b>	<b>7</b>
<b>PËRZGJEDHJA E KOMUNAVE.....</b>	<b>7</b>
<b>RENDITJA EKOMUNAVE .....</b>	<b>7</b>
<b>TRANSPARENCA NË KOMUNË.....</b>	<b>11</b>
<b>TRANSPARENCA NË PRISHTINË .....</b>	<b>12</b>
<b>TRANSPARENCA NË PRIZREN.....</b>	<b>14</b>
<b>TRANSPARENCA NË GJAKOVË.....</b>	<b>16</b>
<b>TRANSPARENCA NË GJILAN.....</b>	<b>18</b>
<b>TRANSPARENCA NË GRAÇANICË .....</b>	<b>20</b>
<b>TRANSPARENCA NË DEÇAN .....</b>	<b>22</b>
<b>REKOMANDIMET .....</b>	<b>24</b>
<b>ANEKSET. INDIKATORËT DHE KOMENTET .....</b>	<b>26</b>



# HYRJE

Transparenca dhe hapja e një institucioni ndaj publikut është tregues thelbësor për mënyrën e qeverisjes së atij institucioni nga udhëheqësit, të zgjedhurit. Në një sistem të shëndoshë demokratik, secili institucion publik qoftë lokal apo qendror duhet të jetë transparent dhe i hapur, në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar dhe të kenë mundësi të marrin pjesë aktive në proceset e vendim-marrjes. Në kuptimin e ngushtë të fjalës, një institucion konsiderohet i hapur, kur para së gjithash qytetarëve u mundësohet që të jenë të pranishëm, madje edhe fizikisht dhe të përcjellin nga afër punimet e tij.

Rëndësia e transparencës shtohet edhe më tutje kur kemi të bëjmë me institucionet lokale. Ato si të tilla janë mekanizmi i parë ku qytetari adreson problemet dhe shqetësimet e tij dhe komunitetit. Rruga, trotuaret, uji, kanalizimet, shkollat, mirëqenia janë problemet jo vetëm që duan zgjidhje nga autoritetet lokale, por edhe alternativat për zgjidhje duhet të nxjerrjen pas një procesi transparent dhe pas një konsultimi të gjerë me qytetarët e asaj komune.

Nëse ndodh e kundërta, kjo mund të qoj në keqpërdorime të pushtetit, niveli i ulët i këtij elementi thelbësor të qeverisjes, transparencës ndaj publikut, shkakton mos informim të duhur të publikut, ngrit mosinteresimin e publikut në punët publike dhe ulë pjesëmarrjen qytetare, një tjetër element i rëndësishëm për qeverisje të mirë.

Në kontekstin e bazës ligjore për transparencë në Komuna, vendi ynë ka një kornizë solide e cila garanton institucione transparente në funksion të qytetarëve të saj. Kushtetuta, ligji për vetëqeverisjen lokale, ligji për qasjen në dokumente publike janë dokumentet themelore që përcaktojnë transparencën e institucioneve lokale. Normalisht me jo më pak rëndësi janë edhe aktet dhe konventat ndërkombëtare si Karta e Evropiane e për Vetëqeverisjen Lokale, të cilat Kosova edhe pse ende nuk është palë nënshkruese i ka pranuar si akte të zbatueshme në legjislacionin vendor.

Me qëllim të përmirësimit të këtij procesi KDI ka filluar monitorimin e 6 Komunave të Regjionit të Prizrenit, me theks të veçantë transparencën e tyre karshi publikut. Kjo matje realizohet përmes një indeksi i cili ngërthen në vete 44 indikatorë matës të transparencës komunale. Përmes këtyre indikatorëve provohet të silltet një metodologji të lehtë dhe objektive për matje të transparencës në komuna dhe gatishmërinë e zyrtarëve lokal për të qenë të hapur ndaj publikut dhe gjithëpërfshirës në vendimmarrje. Pra, Transparametri përbën në vete një mekanizëm të krahasimit të transparencës së qeverive lokale të udhëhequra nga subjekte të ndryshme politike. Po ashtu, ky indeks krijon mundësinë që të dallohen komunat me performancë më të mirë nga ato me performancë më të dobët në qeverisje dhe të mënjanojë përgjithësimet në vlerësim të komunave që shpesh janë abuzuar nga akterë të ndryshëm.



# METODOLOGJIA

Vlerësimi i Transparometrit ndjek një metodologji të matjes së indikatorëve në mënyrë objektive përgjatë katër shtyllave themelore të qeverisjes lokale. Ky indeks përbëhet nga 44 indikatorë dhe matë transparencën në Zyrën e Kryetarit/es, Kuvendin e Komunës, Financat Komunale dhe transparencën në Konsultime me Publikun (secila nga katër shtyllat përmban nga 11 indikatorë).

Indikatorët janë përzgjedhur me kujdes duke u bazuar në përgjegjësitë dhe kompetencat nën qeverisjen lokale që përcaktohen me ligjet në fuqi. Indikatorët prekin përgjegjësitë bazike të qeverive lokale, aty ku transparenca duhet të jetë e garantuar, dhe nuk shkon në thellësi të matë transparencën edhe në disa sektorë specifik që janë nën kompetencën e komunës si transparenca në shëndetësi, arsim apo planifikim urban.

## RËNDËSIA DHE VLERËSIMI I INDIKATORËVE

Rëndësia dhe pesha e indikatorëve është përcaktuar varësisht nga ndikimi që mund të ketë në kontekstin e transparencës së institucioneve komunale.

Kjo rëndësi e indikatorëve është shprehur në numra dhe varion nga 1 deri në 3 (shikoni Aneksin 1 për indikatorët dhe peshën e tyre). Për secilën nga katër shtyllat, pesha maksimale e 11 indikatorëve së bashku është 35.

Ndërsa vlerësimi i secilit indikatorë është bërë me notën 0 deri në 3 (0 është dhënë aty ku komuna s'ka qenë fare transparente, 3 është dhënë në ata indikatorë ku komunat kanë qenë plotësisht transparente, ndërsa 1 dhe 2 janë dhënë për ata indikatorë ku komuna ka qenë pjesërisht transparente). Nota vlerësuese (0-3) është përpjesëtuar me peshën indikatorit dhe është nxjerrë një vlerësimi i atij indikatorit. Shuma e notave vlerësuese të 11 indikatorëve ka dhënë dhe notën e përgjithshme për komunën në atë shtyllë (Zyre të Kryetarit/es, Kuvend Komunal etj).

Matja e transparencës së indikatorëve është bërë përmes katër mënyrave: ueb-faqes zyrtare të komunës, intervistimit të zyrtarëve komunal (pozitë dhe opozitë), monitorimit të takimeve zyrtare të komunave dhe kërkesave për qasje në dokumente publike.

## PËRZGJEDHJA E KOMUNAVE

Një nga qëllimet e Transparometrit është edhe nxitja e konkurrencës për performancë më të mirë në transparencë. Andaj, në vlerësimin e indeksit që do të shpaloset më poshtë janë të përfshira gjashtë (6) komuna që udhëhiqen nga subjekte politike të ndryshme. Janë përzgjedhur katër komuna më urbane të Kosovës që udhëhiqen nga subjekte të ndryshme dhe dy komuna me popullsi mesatare që poashtu udhëhiqen nga subjekte të ndryshme. Komunat e përfshira në këtë indeks janë Komuna e Prishtinës, Komuna e Prizrenit, Komuna e Gjilanit, Komuna e Gjakovës, Komuna e dhe Komuna e Graçanicës.

## RENDITJA EKOMUNAVE

Nga 44 indikatorët matës që përbëjnë këtë indeks, kryesisht në katër fusha thelbësore të qeverisjes lokale, asnjë komunë nuk del të jetë 100% transparente. Kjo tregon që edhe komunat me performancën më të mirë në qeverisje kanë ende punë për të bërë që të jenë plotësisht transparente, së paku në këto çështje thelbësore të qeverisjes që ky indeks i adreson.

Disa pengesa tek transparenca komunale shkaktohen nga Ministria për Administratë Publike për shkak se ajo është përgjegjëse për platformën dhe menaxhimin e ueb-faqeve të komunave, gjë që kufizon komunat në përpjekje për të bërë dokumente dhe informata lehtë të qasshme për qytetarët e saj. Ueb-faqet e komunave janë të centralizuara dhe nuk lejojnë hapësirë për modernizim dhe përshtatje të ueb-faqeve për qytetarët nga komunat e tyre përkatëse. Duke pasur parasysh përdorimin e internetit në kohët e sotme, ueb-faqet janë tejet të rëndësishme për institucionet publike të bëjnë informatat dhe dokumentet lehtë të qasshme për publikun.

Përgjegjësia më e madhe për hapje të komunës ndaj qytetarëve i mbetet udhëheqësve lokal dhe administratës lokale. Shpërndarja e informatës për planet, planifikimet buxhetore dhe planifikimet e projekteve mbeten sfida që

duhet të adresohen dhe praktikohen nga vetë udhëheqësit komunal. Gjatë punës tone, shumë herë kemi has në mos gatishmëri për të ndarë informatën, herë për shkak të mos vullnetit, herë për shkak të frikës se zyrtarëve të administratës për të ndarë një informatë publike pa dijen e udhëheqësve politik të komunave.

MAPL gjithashtu mund të bëjë shumë më shumë që rregulloret që i lëshon të zbatohen në nivel komunal. Kjo ministri shpesh anashkalon mbikëqyrjen e zbatimit të rregulloreve për komuna. Kurse Asociacion i Komunave mund të bëjmë më shumë në koordinimin e komunave që të adresojnë sfidat me të cilat komunat përballen për të qenë më të hapur ndaj publikut dhe më të qasshëm nga publiku dhe si të ngriten kapacitetet për të qenë më transparent.

Nga 44 indikatorët matës të transparencës që përbëjnë këtë Transparometër (shih metodologjinë për përzgjedhje e indikatorëve dhe Aneksin 1 për indikatorët dhe peshën e tyre në vlerësim) del se disa ngecje në qeverisje komunat i kanë të përbashkëta dhe kurse disa ngecje që qëndrojnë tek një komunë nuk qëndrojnë tek disa të tjera. Të gjeturat e këtij indeksi tregojnë që performanca në transparencë e komunave dallon dhedisa komuna janë në rrugë të mirë për të arritur transparencë totale në çështje bazike.




SHTYLLA	PIKË TË MUNDSHME	VLERËSIMI PËR KOMUNË					
		Prishtinë	Prizren	Gjakovë	Gjilan	Deçan	Graçanicë
Ekzekutivi	35.0	27.3	17.3	28.0	26.0	19.3	13.7
Kuvend	35.0	27.7	23.0	28.70	34.0	25.0	23.3
Financa	35.0	27.7	26.3	30.3	18.3	16.3	17.7
Konsultime me publikun	35.0	28.7	15.3	30.3	27.3	24.3	18.0
<b>Pikë/Komunë</b>	<b>140</b>	<b>111.4</b>	<b>81.9</b>	<b>117.3</b>	<b>105.6</b>	<b>84.9</b>	<b>72.7</b>
Mesatarja e Pikëve	<b>35</b>	<b>27.9</b>	<b>20.5</b>	<b>29.3</b>	<b>26.4</b>	<b>21.2</b>	<b>18.2</b>
<b>Niveli i Transparencës</b>		<b>79.6 %</b>	<b>58.5 %</b>	<b>83.8 %</b>	<b>75.4 %</b>	<b>60.6 %</b>	<b>51.9 %</b>



Në bazë të gjeturave të këtij indeksi me 44 indikatorë në katër fushat bazike të qeverisjes lokale, të matur për periudhën një vjeçare (janar-dhjetor 2016) del se Komuna e Gjakovës ka qenë komuna me transparente nga gjatë komunat e matura me 83.8 % transparente. Pastaj radhiten

Komuna e Prishtinës (79.6 % transparente), Komuna e Gjilanit (75.4 % transparente), Komuna e Deçanit (60.6 % transparente), Komuna e Prizrenit (58.5 % transparente) dhe Komuna e Graçanicës me (51.9 % transparente).

## ✓ NIVELI I TRANSPARENCËS KOMUNALE






- Radhitja e komunave për nga performanca më e mirë në **Transparimetrin e Zyrës së Kryetarit/es**, nga 35 pikët e mundshme, del të jetë Komuna e Gjakovës (28.0 pikë), Komuna e Prishtinës (27.3 pikë), Komuna e Gjilanit (26.0 pikë), Komuna e Deçanit (19.3 pikë), Komuna e Prizrenit (17.3pikë) dhe Komuna e Graçanicës (13.7 pikë).
- Radhitja e komunave për nga performanca më e mirë në **Transparimetrin e Kuvendit të Komunës**, nga 35 pikët e mundshme, del të jetë Komuna e Gjilanit (34.0 pikë), Komuna e Gjakovës (me 28.7 pikë) Komuna e Prishtinës (me 27.7 pikë), Komuna e Deçanit me (25.0 pikë), Komuna e Graçanicës me (23.3 pikë)), dhe më së paku transparente del të jetë Komuna e Prizrenit (me 23.0 pikë)
- Radhitja e komunave për nga performanca më e mirë në **Transparimetrin e Financave Komunale**, nga 35 pikët e mundshme, del të jetë Komuna e Gjakovës (30.3 pikë), Komuna e Prishtinës (27.7 pikë), Komuna e Prizrenit (26.3 pikë), Komuna e Gjilanit me (18.3 pikë), Komuna e Graçanicës me (17.7 pikë) si dhe Komuna e Deçanit me ( 16.3pikë).
- Radhitja e komunave për nga performanca më e mirë në **Transparimetrin e Konsultimeve me Publikun**, nga 35 pikët e mundshme, del të jetë Komuna Gjakovës (me 30.3 pikë), Komuna e Prishtinës (28.7 pikë), Komuna e Gjilanit (me 27.3pikë), Komuna e Deçanit (24.3 pikë), Komuna e Graçanicës (18.0 pikë) dhe Komuna e Prizrenit (15.3 pikë).



# **TRANSPARENCA NË KOMUNË**



# TRANSPARENCA NË PRISHTINË (VV)



Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2016 ka shënuar rritje të përbushjes së indikatorëve vlerësues të transparencës në bazë të metodologjisë të përdorur në transparometër. Në periudhën janar-qershor 2015 komuna e Prishtinës kishte përbushur 70.8 % të indikatorëve vlerësues dhe në periudhën janar-qershor 2016 ka shënuar rritje të nivelit të e transparencës 79.60 %.

Shtylla në të cilën Komuna e Prishtinës ka marrë më së shumti pikë në krahasim me shtyllat tjera është Transparenca në konsultimet me publikun me 28.7 pikë nga 35 sa edhe është maksimumi i pikëve. Vlen të theksohet se gjatë vitit 2016 Komuna e Prishtinës ka avancuar në hapjen e të dhënave statistikore “Open Data” duke u bërë komuna e parë në hapjen e të dhënave statistikore krahas të dhënave tjera përmes mekanizmit të ueb faqes së komunës.

Organizimi i dëgjimeve buxhetore dhe konsultave të vazhdueshme me qytetarë ka vazhduar edhe gjatë vitit 2016. Një nga avancimet e konsultimit të publikut mbetet edhe lansimi i platformës online për pjesëmarrjen e publikut ku përmes kësaj platformë qytetarët kanë mundësin e votimit dhe parashtrimin e kërkesave për çështjet e ndryshme brenda komunitetit në lagje dhe fshatra të kësaj komune.

Megjithatë, Komuna e Prishtinës edhe gjatë vitit 2016 ka stagnuar në procesin e konsolidimit të Këshillave të lagjeve urbane dhe fshatrave. Përkundër përpjekjeve që të zgjidhen këtë mekanizma, komuna e Prishtinës këtë vit ka

dështuar në miratimin e Rregullores si proces paraprijës në themelimin e Këshillave të lagjeve urbane dhe vend-banimeve.

Një nga indikatorët e vlerësuar minimalisht gjatë vitit 2016 mbetet mungesa e publikimit të procesverbaleve nga organizimet e shumta që kishte komuna e Prishtinës me qytetarë, duke publikuar vetëm njoftimet gjeneralë në formë të lajmeve mbi rrjedhën e procesit të organizimit të takimeve, dëgjimeve dhe konsultimeve.



**“Transparenca e Kuvendit të Komunës”.** Gjatë vitit 2016 ka shënuar rritje duke u bërë shtylla e dytë më transparente, ku nga 35 pikë sa është maksimalja është vlerësuar me 27.7 pikë.

Kuvendi i Komunës së Prishtinës është vlerësuar relativisht mirë tek disa indikatorë për arsye se nuk ka arrit të përbushë kriterin ligjor në mbajtjen e 10 seancave të rregullta brenda vitit, nuk ka bërë njoftimet për mbajtjen e takimeve të komiteteve tjera funksionale të Kuvendit të Komunës pos atyre obligative, nuk kemi azhurnim maksimal në detajet biografike të anëtarëve të Kuvendit të Komunës si dhe nuk ka pasqyruar Planin Vjetor për transparencë për vitin 2016 sipas udhëzimeve të MAPL-s. Megjithatë, Komuna e Prishtinës ka të hartuar Planin e Integritetit që në një mënyrë ndërthen planifikimet e komunës për transparencë.





Më notë minimalë, Kuvendi i Komunës së Prishtinës është vlerësuar në publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, ku edhe gjatë vitit 2016 këto dokumente nuk janë pasqyruar në kohë reale dhe ka pasur vonesa në publikimin e tyre.



**Transparenca Financiare.** Në Komunën e Prishtinës mbetet shtylla e katërt e vlerësuar gjatë vitit 2016 ku nga 35 pikë sa është maksimalja është vlerësuar me 25.3 pikë.

Në këtë shtyllë, Komuna e Prishtinës është vlerësuar me notë relativisht të mirë për shkak të vonës në publikimin e raporteve të mujore financiare, raport ky që ngërthen edhe raportin e të hyrave vetanake të komunës dhe raportin e borxhit publik komunal të komunës ndaj operatorëve të ndryshëm dhe palëve tjera në proceset gjyqësore.

Gjatë vitit 2016, komuna e Prishtinës është vlerësuar negativisht në një indikatorë të vetëm tek *“ndryshimet buxhetore të miratuara në Kuvendin e Komunës”* për shkak të mos ri-shikimit të buxhetit në Kuvendin e Komunës gjatë vitit 2016.

Komuna e Prishtinës është vlerësuar minimalisht në një indikatorë tjetër të rëndësishëm sa i përket transparencës financiare *“diskutimi në kuvend i raporteve tre mujore financiare 2016”*. Gjatë kësaj periudhe, vetëm në seancën e datës 08.06.2016 ka qenë e paraparë në rend dite të diskutohet raporti tre-mujor financiar janar-mars 2016 dhe në asnjë nga seancat tjera të këtij viti nuk janë trajtuar në seancat e Kuvendit të Komunës raportet tre mujore financiare. Edhe raporti përfundimtarë financiar i vitit 2015, ka ardhur me vonesë për diskutim në Kuvendin e Komunës së Prishtinës, ky raport ka qenë pjesë e rendit të ditës në seancën e datës 27.05.2016 për diskutim.

Ekzekutivi i komunës përmes formës elektronike i ka dërguar anëtarëve të Kuvendit të Komunës raportet tre mujore financiare, megjithatë ekzekutivi i komunës duhet të bëjë përpjekje maksimale në respektimin e ligjit për menaxhimin e financave dhe përgjegjësive duke dërguar për diskutim raportet e tilla në Kuvendin e Komunës të përcaktuara me këtë ligj.



**Transparenca në Zyren e Kryetarit/es.** Ksë Komunës, nga 35 pikë sa është maksimalja gjatë vitit 2016 është vlerësuar me 27.3 pikë duke u renditur me transparencë më të vogël në krahasim me tjera të vlerësuar në kuadër të metodologjisë së këtij Transparometri.

Në këtë shtyllë, komuna e Prishtinës është vlerësuar negativisht në dy indikatorë *“publikimi i planit të punës së Kryetarit të komunës për vitin 2016”* si dhe *“raportimi i Kryetarit në Kuvendin e Komunës për raportin e punës në baza gjashtë mujore”*. Pra, gjatë vitit 2016, Kryetari i Komunës së Prishtinës ka dështuar në llogaridhënie për punën e tij para anëtarëve të institucionit më të lartë vetëqeverisës si dhe nuk ka publikuar planin e punës së tij për vitin 2016.


Tetë (8) nga indikatorët tjerë në këtë shtyllë janë vlerësuar me nota maksimale derisa publikimi i raportit 6 mujor i punës është vlerësuar relativisht mirë për faktin e publikimit të raportit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2015 në fillim të vitit 2016, publikimi i raporteve nga ana e drejtorive në baza mujore deri në muajin gusht 2016 derisa edhe gjatë majit janar 2017, kryetari i komunës së Prishtinës nuk ka publikuar raportin vjetor të punës së tij për vitin 2016.





# TRANSPARENCA NË

## PRIZRENIT (PDK)



Janar - Dhjetor 2016

Komuna e Prizrenit del të jetë komuna e katërt më transparente, me një nivel të transparencës prej 58.5 %. Institucioni më transparent i Komunës së Prizrenit është shtylla e financave, në të cilin kjo komunë është vlerësuar me 26.3 pikë, ndërsa Komuna e Prizrenit është më pak transparente në shtyllën e Konsultimeve me publikun ku është vlerësuar me nga 15.3 pikë nga 35 pikë sa është maksimalja e vlerësimit.



**“Transparenca Financiar e Komunës”.** Komuna e Prizrenit gjatë periudhës vlerësuese të transparencës në këtë shtyllë ka arritur të akumulojë 26.3 pikë nga 35 pikë sa është maksimalja vlerësuar në 11 indikatorë bazik.

Sipas të dhënave të mbledhura për këtë hulumtim, vlerësimin më të lartë ka marr tek “ndryshimet buxhetore të miratuara në Kuvendin e Komunës”, “raporti i shpenzimeve tre mujore të publikuara në ueb faqen e komunës”, “publikimi i raportit të auditorit të përgjithshëm” “publikimi i të hyrave vetanake të komunës”, “publikimi i njoftimeve për kontratë dhe për dhënien e kontratës në ueb faqen e komunës” si dhe “lista e pronave (zyre, lokale) në pronësi dhe të marra me qira për komunën”.

Në gjithë këta indikatorë, Komuna e Prizrenit është vlerësuar maksimalisht për faktin e respektimit të afateve dhe procedurave për ardhjen në kuvend të ndryshimeve buxhetore (rishikimi i buxhetit) edhe përkundër mos miratimit

të tij në Kuvend, si dhe ka respektuar legjislacionin bazë në publikimin e raporteve tre mujore financiare.

Me nota të mirë është vlerësuar edhe në këta indikatorë si: “*diskutimi brenda afateve ligjore në Kuvend të shpenzimeve tre mujore*”, “*plani dhe buxheti i projekteve kapitale për vitin 2016*”, si dhe “*publikimi i kontratave*”. Gjatë kësaj periudhe, KDI ka testuar gatishmërinë e Komunës së Prizrenit në publikimin e kontratave me Operatorët Ekonomik dhe të njëjtat kontrata nuk janë ofruar në tërësi në bazë të kërkesave të parashtruara.

Minimalisht është vlerësuar në vetëm në një indikatorë tek “*publikimi i planit të prokurimit për vitin 2016*”. Komuna e Prizrenit është vlerësuar kështu për arsye se nuk e ka publikuar planin e prokurimit për vitin 2016 në ueb faqen e komunës mirëpo Kuvendi i Komunës në njërin nga seancat e vitit 2016 ka shqyrtuar planin e tilli i ofruar nga Zyra e Prokurimit duke krijuar një praktikë të re në përpjekjet për transparencë më të madhe në prokurimin publikë karshi Kuvendit të Komunës.

Ndërsa mungesë të transparencës Komuna e Prizrenit ka treguar tek “*mos publikimi i borxhit publik komunal në ueb faqen e komunës*”. Komuna e Prizrenit ka dështuar në publikimin e borxhit publik komunal duke mos pasqyruar obligimet ndaj Operatorëve Ekonomik në kuadër të raporteve tre mujore financiare.





**“Transparenca e Kuvendit të Komunës”.** *Transparenca e Ekzekutivit* është vlerësuar me 17.3 nga 35 pikë maksimale. Ekzekutivi i komunës është vlerësuar me notë maksimale vetëm në 2 nga 11 indikatorët e kësaj shtylle si: *“vendimet e kryetarit të Komunës” si dhe “zyrtarë për informim dhe koordinim për qasje në dokumente publike”, “Konkursi dhe kriteret në ueb faqe për punësim”*. Po ashtu, në 5 nga 11 indikatorët është vlerësuar më notë të mirë megjithatë nuk ka qenë plotësisht transparentë në këtë gjashtëmujorë. *“niveli i kthimit të përgjigjeve për qasje në dokumente publike”, “publikimi i planeve urbanistike të komunës”, “detajet biografike të Kryetarit dhe Drejtorëve të drejtorive komunale” si dhe “ueb faqja e azhuruar në gjuhë tjera zyrtare”*.

Gjatë kësaj periudhe, komuna e Prizrenit në kërkesat për qasje në dokumente publike nuk ka respektuar afatet ligjore në kthimin e përgjigjeve duke u vonuar dhe shkaktuar vonesa si dhe në një rast të caktuar nuk ka kthyer përgjigje fare.

Ekzekutivi i Komunës së Prizrenit është vlerësuar negativisht në 3 nga 11 indikatorët e kësaj shtylle. Gjatë kësaj periudhe ekzekutivi i komunës nuk kishte të publikuar planin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2016, nuk është praktikuar dhe vendosur për një ditë të caktuar për pritjen e qytetarëve dhe palëve tjera të interesit si dhe Kryetari i Komunës nuk ka raportuar në Kuvend për punën e tij gjashtëmujore.

Me notë minimale në këtë periudhë, zyra e kryetarit është vlerësuar në indikatorin e publikimit të raportit të punës në ëeb faqen e komunës për periudhën gjashtë mujore. Vetëm disa nga drejtoritë komunale të ekzekutivit të komunës kanë të publikuara raportet e punës për periudhën janar-qershor 2016 duke bërë që puna e qeveris lokale në baza periodike të jetë fare pak transparente.



**“Transparenca e Kuvendit të Komunës”.** Është shtylla e dytë me nivel më të lartë të transparencës pas transparencës financiare me 23.0 pikë nga 35 sa është maksimalja e pikëve. Komuna e Prizrenit qëndron mirë në këto fusha: *“takime e seancave të hapura për publik”, “transmetimi i drejtpërdrejt i seancave të kuvendit të komunës”, “numri i mbajtjes së seancave të rregullta sipas legjislacionit”, “publikimi i planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016 në ueb faqen e komunës” si dhe “publikimi i planit të veprimit për transparencë”*.

Gjatë kësaj periudhe 2 nga 11 indikatorët vlerësues, kuvendi ka marrë nota të mira në “qasjen në rendin e ditës për mbledhjet e kuvendit të komunës”, *“qasja në draftet*

*e rregulloreve dhe planet”, “komitetet e hapura me publikun” si dhe “qasja në rregulloret komunale dhe vendimet”*. Këtë vlerësim ka arritur për shkak të njoftimeve me kohë për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës si dhe njoftimi për pikat e rendit të ditës.

Po ashtu, Kuvendi i Komunës është treguar transparent sa i përket publikimit të vendimeve të këtij institucioni mirëpo disa nga rregulloret e miratuara në këtë institucion nuk kanë qenë të publikuara në ueb faqen e komunës së Prizrenit.

Me nota minimale, Kuvendi i Komunës është vlerësuar tek indikatorin vlerësues *“detajet biografike dhe email adresat e anëtarëve të kuvendit”*, ku edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur azhurim të detajeve biografike për anëtarë të Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka treguar mos transparencë totale vetëm në një nga 11 indikatorët. Deri më tani asnjë nga procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës gjatë periudhës korrik-dhjetor 2016 nuk kanë qenë të pasqyruara në ëeb faqen e komunës.



**“Transparenca në Konsultime me Publikun”.** Kjo komunë ka marrë 15.3 pikë nga 35.0 pikë të mundshme. Komuna e Prizrenit, ka mbajtur “organizimin e dëgjimeve publike dhe dëgjimet buxhetore (1 për 25 mijë banorë), “njoftimet online dhe offline për takimet publike” duke u vlerësuar maksimalisht në këtë periudhë.

Komuna e Prizrenit është vlerësuar mire në organizimin e konsultimeve publike ku gjatë kësaj periudhe ka organizuar debat me qytetarë për projekt buxhetin e Komunës së Prizrenit për vitin fiskal 2017 si dhe njoftimet online dhe offline për takimet publike përmes ueb faqes së komunës dhe mekanizmave tjera. Po ashtu, Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka organizuar dëgjime publike me Kryetarë të bashkësive lokale për projektbuxhetin e komunës për vitin 2017.


Me nota minimale në këtë shtyllë janë vlerësuar 4 nga 11 indikatorët bazë, tek: *“hapja e të dhënave statistikore (open data)”, “listën e hollësishme të shërbimeve që ofron institucioni për publikun” si dhe nuk ka organizuar takime me organizatat e Shoqërisë Civile*.

Dy nga indikatorët vlerësuar në këtë shtyllë janë vlerësuar negativisht për shkak se komuna e Prizrenit nuk ka filluar të praktikojë mbajtjen e raporteve apo procesverbaleve gjatë organizimit të konsultimeve për politika publike dhe dëgjimet buxhetore. Po ashtu, edhe në këtë gjashtë mujorë të këtij viti, komuna e Prizrenit nuk ka arritur të këtë një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët e saj.





# TRANSPARENCA NË GJAKOVË



Komuna e Gjakovës në raportin e KDI të publikuar në nëntor të 2014-së kishte dalë të jetë komuna më transparente nga gjashtë komunat e vlerësuara me një nivel të transparencës prej 76.4% derisa në vitin 2015 kishte rënie duke u vlerësuar me 64.5 %. Kjo komunë, në vitin 2016 ka arritur të përmirësojë indikatorët vlerësues të përdorura në metodologjinë e këtij Transparometri duke u vlerësuar me 83.8 % të nivelit të transparencës.

Dy shtyllat me transparencë më të madhe gjatë vitit 2016 ishin transparenca financiare si dhe transparenca në konsultim me publikun. Transparenca në konsultimet me publikun është vlerësuar me 30.3 pikë nga 35 sa edhe është maksimumi i pikëve. Edhe komuna e Gjakovës gjatë vitit 2016 ka avancuar në hapjen e të dhënave statistikore “Open Data” duke ndjekur shembullin e komunës së Prishtinës në hapjen e të dhënave shtesë në ueb faqen e komunës.

Megjithatë, Komuna e Gjakovës edhe gjatë vitit 2016 ka stagnuar në procesin publikimit të listës në ofrimin e shërbimeve nga dikasteret komunal dhe procedura e marrjes së këtyre shërbimeve si dhe në mbajtjen dhe publikimin e procesverbaleve nga organizimet e ndryshme për konsultim të qytetarëve për politika publike si dhe dëgjimeve buxhetore. Pos në praktikumin e njoftimeve gjeneralë mbi ecurinë e konsultimeve publike dhe dëgjimeve buxhetore, Komuna e Gjakovës duhet të fillojë në mbajtjen e procesverbaleve nga konsultimet tilla me publikun.



**“Transparenca Financiare”**. Në Komunën e Gjakovës nga 35 pikë sa është maksimalja është vlerësuar me 33.3 pikë gjatë vitit 2016. Në këtë shtyllë, Komuna e Gjakovës duhet të shtojë përpjekjet në transparencë më të madhe të borxhit publik komunal në kuadër të raportimeve të rregullta tre mujore financiare si dhe në pasqyrimin ndaras të të hyrave vetanake të komunës në baza të rregullta tre mujore.



**“Transparenca Financiare”**. Në Komunën e Gjakovës nga 35 pikë sa është maksimalja është vlerësuar me 33.3 pikë gjatë vitit 2016. Në këtë shtyllë, Komuna e Gjakovës duhet të shtojë përpjekjet në transparencë më të madhe të borxhit publik komunal në kuadër të raportimeve të rregullta tre mujore financiare si dhe në pasqyrimin ndaras të të hyrave vetanake të komunës në baza të rregullta tre mujore.







Një nga indikatorët që nuk i ka përmbushë Kuvendi i Komunës së Gjakovës mbetet mos publikimi i Planit të Punës së këtij institucioni për vitin 2016 andaj ky institucion duhet të jep theksin e publikimit të planit të Punës për vitin 2017 me qëllim që qytetarët të kenë mundësin e qasjes në planin e till të punës së këtij institucioni.



**"Transparenca në Kuvend e Komunës"**. Gjatë vitit 2016 ka shënuar rritje duke u bërë shtylla e tretë më transparente, ku nga 35 pikë sa është maksimalja është vlerësuar me 28.7 pikë. Nga 11 indikatorë vlerësues në këtë shtyllë, dy prej tyre janë vlerësuar relativisht apo minimalishtsi dhe një prej indikatorëve vlerësues është vlerësuar negativisht gjatë vitit 2016.

Kuvendi i Komunës së Gjakovës nuk ka pasqyruar Planin Vjetor për transparencë për vitin 2016 sipas udhëzimeve të MAPL-s. Megjithatë, Komuna e Gjakovës ka të hartuar Planin e Integritetit që në një mënyrë ngërthen planifikimet e komunës për transparencë. Po ashtu, Komuna e Gjakovës gjatë vitit 2016 ka publikuar vetëm një draft rregullore komunale e cila ju ka nënshtruar diskutimit publik gjatë vitit 2016.

Një nga indikatorët që nuk i ka përmbushë Kuvendi i Komunës së Gjakovës mbetet mos publikimi i Planit të Punës së këtij institucioni për vitin 2016 andaj ky institucion duhet të jep theksin e publikimit të planit të Punës për vitin 2017 me qëllim që qytetarët të kenë mundësin e qasjes në planin e till të punës së këtij institucioni.



**"Transparenca në Zyren e Kryetarit/es së Komunës"**. Nga 35 pikë sa është maksimalja gjatë vitit 2016 është vlerësuar me 28.0 pikë duke u renditur me transparencë më të vogël në krahasim me shtyllat tjera të vlerësuar në kuadër të metodologjisë së këtij Transparometri.


Në këtë shtyllë, komuna e Gjakovës është vlerësuar negativisht në një indikatorë "ueb faqja në gjuhën tjetër zyrtare". Pra, komuna e Gjakovës ka dështuar në arritjen e standardeve të përcaktuara me legjislacionin sa i përket respektimit të gjuhëve zyrtare dhe publikimi i dokumentacioneve dhe vendimeve në dy gjuhësi.

Dy nga indikatorët tjerë janë vlerësuar relativisht mirë për faktin e vonesës që kishte komuna e Gjakovës në publikimin e vendimeve të Kryetares si dhe mos pasqyrimi në tërësi i raporteve gjashtë mujore të punës në ueb faqen zyrtare të komunës.



# TRANSPARENCA NË

## GJILAN (LDK)



Janar - Dhjetor 2016

Komuna e Gjilanit në krahasim me periudhën janar-qershor 2015 e cila ishte vlerësuar me 66.7 %, gjatë vitit 2016 ka shënuar ngritje duke u vlerësuar me 75.4 % të nivelit të përgjithshëm të transparencës bazuar në 44 indikatorë dhe metodologjinë e përdorur në këtë transparometër.



**“Transparenca e Kuvendit të Komunës”.** Gjatë vitit 2016 është vlerësuar si shtylla më transparente , ku nga 35 pikë sa është maksimalja është vlerësuar me 34 pikë dhe mbetet një nga shtyllat më transparente krahasuar me komunat tjera të përfshira në këtë transparometër. Nga 11 indikatorët në këtë shtyllë, në 10 prej tyre është vlerësuar me nota maksimale derisa vetëm tek një indikatorë *“qasja në draft rregulloret dhe planet”* është vlerësuar më pak.



**“Transparenca në Konsultime Publike”.** është shtylla më transparente më të madhe në Komunën e Gjilanit, ku nga 35 pikë maksimale është vlerësuar me 27.3 pikë. Nga 11 indikatorët në gjashtë (6) prej tyre është vlerësuar maksimalisht, në tre indikatorët është vlerësuar relativisht mirë dhe vetëm në dy prej indikatorëve është vlerësuar minimalisht gjatë kësaj periudhe.

Në këtë shtyllë, komuna e Gjilanit duhet të shtojë përpjekjet

në përpilimin e procesverbaleve dhe publikimit i tyre në ueb faqen e komunës nga takimet dhe organizimet që ka komuna me qytetarë për të diskutuar politikat publike në këtë komunë. Po ashtu, duhet të shtojë përpjekjet e ofrim-it të listës së hollësishme që ofron institucioni për secilin dikaster në këtë komunë. Qasja e tillë do ti mundësonte qytetarëve të kësaj komune të kenë njohuri paraprake me procedurat e marrjes së shërbimeve në nivel lokal.



**“Transparencës së Ekzekutivit”.** Është shtylla e tretë me transparencë, ku nga 35 pikë sa është maksimalja është vlerësuar më 26 pikë bazuar në metodologjinë e transparometirt.

Nga 11 indikatorët vlerësues në këtë shtyllë në shtatë (7) prej tyre është vlerësuar maksimalisht, një nga indikatorët është vlerësuar relativisht mirë dhe në tre indikatorë tjerë ka vlerësim minimal gjatë periudhës janar-dhjetor 2016.

Komuna e Gjilanit është vlerësuar minimalisht në tre indikatorë për arsye të mos publikimit të vendimeve të Kryetarit të Komunës. Një praktikë e mirë e transparencës së vendimmarrjes së Kryetarit të Komunës është ndërprerë që nga muaji prill i vitit 2016 dhe vendimet e Kryetarit nga muaj prill deri ne muajin dhjetor 2016 nuk kanë qenë të publikuara në ueb faqen e komunës.



Po ashtu, Komuna e Gjilanit ka probleme edhe në respektimin e gjuhëve zyrtare duke mos azhuruar me kohë informacionet ne gjuhen tjetër zyrtare në përdorim si dhe gjatë kësaj periudhe në kërkesat e parashtruara nga KDI për qasje në dokumente zyrtare kemi pasur vonesa në kthimin e përgjigjeve nga ana e zyrtarëve përgjegjës.



**”Transparencës financiare”** Kmbetet shtylla me më pak pikë gjatë vitit 2016 ku nga 35 pikë sa është maksimalja është vlerësuar me vetëm 18.3 pikë.

Komuna e Gjilanit gjatë vitit 2016 ka dështuar në pasqyrimin e borxhit publik komunal në baza periodike tek raportet tre mujore financiare, në publikimin e planit të prokurimit, në publikimin e kontratave si dhe në publikimin e raportit nga auditori i përgjithshëm për vitin 2015. KDI duke matur transparencën në publikimin e kontratave, gjatë vitit 2016 ka kërkuar nga komuna e Gjilanit kontratën me OE për furnizim me dru për ngrohje për të gjitha njësit shpenzuese dhe kjo e fundit nuk ka lejuar qasje bazuar në kërkesën e KDI-së.

Me notë minimale, komuna e Gjilanit është vlerësuar edhe tek njoftimi për kontratë dhe dhënien e kontratës, ku gjatë kësaj ku aktivitetet e prokurimit të komunës në ueb faqen zyrtare nuk janë të azhuruara dhe kompletuara në kohë.




Komuna e Gjilanit është vlerësuar minimalisht në tre indikatorë për arsye të mos publikimit të vendimeve të Kryetarit të Komunës. Një praktikë e mirë e transparencës së vendimmarrjes së Kryetarit të Komunës është ndërprerë që nga muaji prill i vitit 2016 dhe vendimet e Kryetarit nga muaj prill deri ne muajin dhjetor 2016 nuk kanë qenë të publikuara në ueb faqen e komunës.





# TRANSPARENCA NË

## GRAÇANICËS (LS)



Me një trend pozitiv të përmirësimit të indikatorëve vlerësuar të përdorur në metodologjinë e transparimetit komunal është karakterizuar edhe Komuna e Graçanicës e cila megjithatë mbetet një ndër komunat me më pak transparencë krahasuar me komunat tjera të targetuara në këtë analizë.

“**Transparenca e Kuvendit të Komunës**”. gjatë vitit 2016 është vlerësuar si shtylla më transparente , ku nga 35 pikë sa është maksimalja është vlerësuar me 23.3 pikë. Nga 11 indikatorët në këtë shtyllë, në 4 prej tyre është vlerësuar me nota maksimale, në 4 prej relativisht mire, në 1 indikatorë është vlerësuar minimalisht dhe në një indikatorë është vlerësuar negativisht.

Në këtë shtyllë, Komuna e Graçanicës duhet të fokusohet në publikimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës, në azhurimin e detajeve biografike të anëtarëve të Kuvendit të Komunës si dhe në gjetjen e mundësive për transmetimin direkt të seancave të Kuvendit të Komunës në ndonjë radio apo Tv lokale.



“**Transparencës së Ekzekutivit**”. është shtylla me më pak transparencë, ku nga 35 pikë sa është maksimalja është vlerësuar më 13.7 pikë bazuar në metodologjinë e transparimetit. Nga 11 indikatorët vlerësues në këtë shtyllë në tre(3) prej tyre është vlerësuar maksimalisht, në dy (2) prej tyre relativisht mirë, dy (2) është vlerësuar minimalisht dhe në katër (4) indikatorë tjerë Komuna e Graçanicës është vlerësuar negativisht.

Kryetari i Komunës së Graçanicës duhet të shtojë përpjekjet në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies për punën e tij karshi qytetarëve dhe kuvendit të komunës si organ më i lartë i vetëqeverisjes lokale. Publikimi i raportit 6 muor të punës në ueb faqen e komunës, publikimin e planit të punës, publikimi i vendimeve të kryetarit të komunës si dhe mungesa e raportimit të Kryetarit të Komunës për punën e tij në baza të rregullta gjashtë muore pranë kuvendit të komunës mbesin sfida kryesore të Kryetarit të Komunës për ti adresuar në vitin 2017 me qëllim të rritjes së transparencës së punës së ekzekutivit komunal.





Mungesa e publikimit të borxhit publik komunal, mungesa e publikimit të raportet të auditorit të jashtëm në ueb faqen e komunës, mungesa e publikimit të listës së pronave dhe asetëve komunale, mungesa e publikimit të planit të prokurimit si dhe mungesa e pasqyrimin të aktiviteteve të prokurimit në ueb faqen zyrtare të komunës së Graçanicës janë indikatorët që kjo komunë duhet të shtojë përpjekjet për t'i adresuar në vitin 2017.



**“Transparenca Financiare”.** Nga 35 pikë sa është maksimalja, komuna e Graçanicës në këtë shtyllë është vlerësuar me 17.3 pikë. Nga 11 indikatorët vlerësues në këtë shtyllë, në pesë (5) prej indikatorëve është vlerësuar negativisht komuna e Graçanicës. Mungesa e publikimit të borxhit publik komunal, mungesa e publikimit të raportet të auditorit të jashtëm në ueb faqen e komunës, mungesa e publikimit të listës së pronave dhe asetëve komunale, mungesa e publikimit të planit të prokurimit si dhe mungesa e pasqyrimin të aktiviteteve të prokurimit në ueb faqen zyrtare të komunës së Graçanicës janë indikatorët që kjo komunë duhet të shtojë përpjekjet për t'i adresuar në vitin 2017.




**“Transparenca në Konsultime me Publikun”.** Në këtë shtyllë kjo komunë ka marrë 18 pikë nga 35.0 të mundshme. Komuna e Graçanicës, edhe në këtë shtyllë është vlerësuar në katër (4) indikatorë negativisht gjatë vitit 2016. Mungesa e publikimit të procesverbaleve nga konsultimet me publikun në dëgjimet buxhetore, mos pajisja e qytetarëve me material përcjellës në konsultimet publike dhe dëgjimet buxhetore, mungesa e ofrimit të një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët e kësaj komune si dhe mos hapja e të dhënave tjera statistikore mbetën sfida për adresim nga ana e Komunës së Graçanicës për vitin 2017.





# TRANSPARENCA NË

## DEÇANI {AAK}



Janar - Dhjetor 2016

Komuna e Deçanit edhe gjatë vitit 2016 ka vazhduar në përmirësimin e disa indikatorëve të përdorur në metodologjinë e transparimetrit. Nga 17.9 pikë mesatare për katër shtyllat e vlerësimit sa kishte në vitin 2015 gjatë periudhës janar-qershor 2016 ka arrit të grumbullojë 21.2 pikë mesatare për katër shtyllat e vlerësimit dhe në secilën shtyllë ka pasur ngritje të lehtë në përmirësimin e indikatorëve bazikë.

mirë në publikimin e strategjisë , një kërkesë e Planit vjetorë të detajuar duhet të përmbushet nga komuna e Deçanit.

Po ashtu, komuna e Deçanit duhet të shtojë përpjekjet në publikimin me kohë të vendimeve, planet, procesverbalet dhe rregulloret e Kuvendit të Komunës duke u mundësuar qytetarëve të njoftohen me kohë për vendimet dhe mbarëvajtjen e seancave të këtij institucioni.



**“Transparenca e Kuvendit Komunal”.** Komuna e Deçanit qëndron më mirë në raport me tri shtyllat tjera, ku nga 35 pikë maksimale është vlerësuar me 25 pikë. Në këtë shtyllë, komuna e Deçanit është vlerësuar negativisht në vetëm një indikatorë dhe atë “në publikimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2016”, ku gjatë gjithë vitit nuk ka arritur të bëjë publikë planin e punës së këtij institucioni.



**“Transparencës së Ekzekutivit”.** Nga 17.3 pikë sa kishte në vitin 2015, tanimë në vitin 2016 ka 19.3 pikë. Përkundër përmirësimit të pikëve mesatare nga viti në vit, Komuna e Deçanit nuk ka publikuar raportin e punës së Kryetarit në ueb faqen zyrtare të komunës, Kryetari i Komunës nuk ka publikuar dhe pasqyruar planin e punës për vitin 2016 në ueb faqen e komunës si dhe Kryetari i komunës së Deçanit nuk ka raportuar për punën e tij në baza vjetore dhe gjashtë mujore në Kuvendin e Komunës.

Nga 11 indikatorë vlerësues, në katër (4) prej tyre është vlerësuar me notë maksimale derisa në 6 prej tyre është vlerësuar relativisht mirë duke u bazuar në matjen sistematike dhe përmbushjen e këtyre indikatorëve nga komuna e Deçanit.

Megjithatë, nga 11 indikatorët vlerësuar, në këtë shtyllë 6 prej indikatorëve janë vlerësuar maksimalisht gjatë vitit 2016 si tek niveli i kthimit të përgjigjeve brenda afatit ligjorë, njoftimi për konkurset, pasqyrimi i detajeve biografike për kryetarin e komunës dhe drejtorë të drejtorive komunale.

Në këtë shtyllë, Komuna e Deçanit duhet të fokusohet në publikimin e Planit vjetorë për transparencë sipas Udhëzimeve Administrative të MAPL-së. Përkundër një praktike të





Komuna e Deçanit qëndron më mirë në raport më tri shtyllat tjera, ku nga 35 pikë maksimale është vlerësuar me 25 pikë. Në këtë shtyllë, komuna e Deçanit është vlerësuar negativisht në vetëm një indikatorë dhe atë “në publikimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2016”, ku gjatë gjithë vitit nuk ka arritur të bëjë publikë planin e punës së këtij institucioni.

Me pikë minimale është vlerësuar në 2 indikatorë tek publikimi i vendimeve të kryetarit në ueb faqen e komunës si dhe azhurimi i ueb faqes në gjuhët tjera zyrtare. Derisa në të kaluarën komuna e Deçanit nuk i ka pasqyruar fare vendimet e Kryetarit të Komunës, gjatë vitit 2016 ka filluar në publikimin e vendimeve por që ka pasur vonesa të konsiderueshme në updatimin e tyre. Përmbajtja e ueb faqes së Komunës së Deçanit në gjuhën tjetër zyrtare nuk ka qenë e azhuruar dhe përmban shumë pak informacione dhe si e tillë nuk përmbushë obligimet ligjore rreth ofrimit të informacioneve dhe transparencës për qytetarët që përdorin gjuhën tjetër zyrtare.



**“Transparencës Financiare”.** Komuna e Deçanit ka shënuar rritje nga viti 2015 ku kishte 9.7 pikë në vitin 2016 është vlerësuar me 16.3 pikë. Megjithatë edhe përkundër përparimeve në përmirësimin e disa prej indikatorëve, prapëseprapë mbetet shtylla me më shumë indikatorë të vlerësuar negativisht, nga 11 indikatorë në këtë shtyllë pesë janë vlerësuar negativisht.

Mungesa e publikimit të raporteve financiare periodike, të hyrat vetanake, prezantimi i borxhit publik komunal, mungesa e publikimit të planit të prokurimit, mungesa e publikimit të raportit të auditimit të jashtëm janë vetëm disa nga indikatorët e pa përmbushur nga ana e Komunës

së Deçanit sa i përket transparencës financiare të kësaj komune.



**“Transparenca në Konsultime Publike”.** është shtylla e dytë më transparencë më të madhe në Komunën e Deçanit, ku nga 35 pikë maksimale është vlerësuar me 24.3 pikë.

Nga 11 indikatorë në gjashtë (6) prej tyre është vlerësuar maksimalisht, në një (1) indikatorët është vlerësuar relativisht mirë dhe vetëm në tre prej indikatorëve është vlerësuar minimalisht gjatë kësaj periudhe. Hapja e të dhënave statistikore nga komuna e Deçanit nuk ka qenë e përmbushur gjatë gjithë vitit 2016 edhe përkundër kërkesës që të fillohet me publikimin e të dhënave statistikore shtesë në ueb faqen e komunës andaj edhe është vlerësuar negativisht në këtë indikatorë gjatë vitit 2016.

Komuna e Deçanit gjithashtu duhet të bëjë përpjekje në përmirësim të dukshme tre nga indikatorët vlerësues në këtë shtyllë: ‘raportet nga konsultimet dhe dëgjimet buxhetore’, ‘takimet me organizata të shoqërisë civile’ si dhe ‘ofrimin e listës së hollësishme të shërbimeve që ofrohet nga institucioni’. Komuna e Deçanit gjatë vitit 2016 nuk ka përpiluar për secilin dikaster komunal listën e ofrimit të shërbimeve dhe procedurat e marrjes së këtyre.





# REKOMANDIMET

## KOMUNA E PRISHTINËS

- **Kryetari i Komunës** të raportojë në Kuvendin e Komunës në baza të rregullta gjashtë mujore për punën e tij
- **Kryetari i Komunës** duhet ti dërgojë për diskutim raportet tre mujore financiare brenda afateve kohore të përcaktuara me legjislacion në Kuvendin e Komunës
- **Komuna e Prishtinës** sa më parë të finalizojë konsolidimin e Këshillave Lokal

## KOMUNA E PRIZRENIT

- **Kuvendi i Komunës të hapet për publik:** Kuvendi i Komunës duhet të publikojë në ueb-faqe të gjitha procesverbalet e Kuvendit.
- **Takime javore me qytetarë:** Kryetari i Komunës duhet ta rezervojë një ditë në javë për vizita me qytetarë që kanë kërkesa dhe propozime për komunën e tyre.
- **Zyra e Kryetarit:** Të raportojë para anëtarëve të Kuvendit për situatën socio-ekonomike dhe për buxhet, (Raport pune, 2 herë në vit sipas legjislacionit në fuqi)
- **Transparenca e shpenzimeve komunale:** Zyra e Kryetarit duhet të publikoj në ueb-faqe borxhin publik komunal, borgjet e ndërmarrjeve komunale.
- **Komuna e Prizrenit** duhet që të mbajë raporte të rregullta nga konsultimet me publikun dhe dëgjimet buxhetore (KAB), si dhe ta publikojë atë në ueb-faqën zyrtare të komunës.
- **Linjë telefonike direktgratis:** Komuna duhet të ketë një linjë direkte në të cilin qytetarët mund të kontaktojnë me komunën;

## KOMUNA E GJAKOVËS

- **Të publikohet** Plani i punës së Kryetarit të Komunës në ueb faqen e komunës
- **Të respektohet** legjislacioni në fuqi sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare (gjuhëve në përdorim në Kosovë)
- **Të prezantohet** në mënyrë periodike borxhi publik komunal në kuadër të raporteve financiare

## KOMUNA E GJILANIT

- **Të publikohet Plani** i prokurimit të komunës në fillim të çdo viti kalendarik
- **Të publikohen kontratat** e komunës me OE për palë të interesuara për kontratat e komunës
- **Të publikohet** në ueb faqen e komunës Raportet e Auditorit të jashtëm
- **Të prezantohet** në mënyrë periodike borxhi publik komunal në kuadër të raporteve financiare







## KOMUNA E DEÇANIT

- **Të publikohet Plani** i punës së Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës në ueb faqen e komunës
- **Kryetari i Komunës** të raportojë në Kuvendin e Komunës në baza të rregullta gjashtë mujore për punën e tij
- **Të publikohet Plani** i prokurimit të komunës në fillim të çdo viti kalendarik
- **Të publikohet në** ueb faqe raportet e punës së kryetarit të komunës
- **Të publikohen** raportet e auditorit të jashtëm

## KOMUNA E GRAÇANICËS

- **Të publikohet Plani** i punës së Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës në ueb faqen e komunës
- **Kryetari i Komunës** të raportojë në Kuvendin e Komunës në baza të rregullta gjashtë mujore për punën e tij
- **Të publikohet** Plani i prokurimit të komunës në fillim të çdo viti kalendarik
- **Të publikohet** në ueb faqe raportet e punës së kryetarit të komunës
- **Të publikohen** raportet e auditorit të jashtëm
- **Të publikohen** në ueb faqe vendimet e kryetarit të komunës



# ANEKSET, INDIKATORËT DHE KOMENTET

## ANEKS 1: INDIKATORËT DHE PESHA E TYRE

#	KUVENDI I KOMUNES	PESHA	#	FINANCAT	PESHA
1	Qasja në rendin e ditës	1	1	Ndryshimet buxhetore të miratuara nga Kuvendi i Komunës	3
2	Seancat e hapura për publikun	3	2	Borxhi publik komunal (borxh i kompanive)	2
3	Transmetimi i drejtëpërdrejt i seancave të Kuvendit	2	3	Raporti i shpenzimeve tremujore	4
4	Qasja në procesverbale	4	4	Raporti i Auditimit	2
5	Qasja në draftet e rregulloreve dhe planeve	3	5	Diskutimet brenda afateve ligjore të shpenzimeve tre-mujore në Kuvend	2
6	Qasja në rregulloret dhe vendimet	5	6	Lista e pronave (zyrat, lokalet, etj) të marra me qira për komunën	3
7	Komitetet e hapura për publikun	3	7	Të hyrat vetanake të Komunës	3
8	Mbajtja e seancave të rregullta (10 brenda vitit)	4	8	Plani buxheti dhe kohëzgjatja e projekteve kapitale	5
9	Plani i punës së Kuvendit	3	9	Plani i Prokurimit	4
10	Detajet biografike dhe email-adresat e Anëtarëve të Kuvendit	3	10	Njoftimet për Kontrat dhe dhënie të Kontrates	2
11	Plani i veprimtimit për Transparenc	4	11	Publikimi i Kontratave	5
<b>PIKË GJITHSEJ</b>		<b>35</b>	<b>PIKË GJITHSEJ</b>		<b>35</b>

|||||

#	ZYRA E KRYETAR/IT/ES	PESHA	#	KONSULTIMET PUBLIKE	PESHA
1	Zyrtarë për informim & Koordinator. Për qasje në D.Z	1	1	Njoftimi on&offline forma tradicionale, gazeta, shpallje) për takime publike	1
2	Raporti gjashtëmujor i punës	5	2	Raport nga Konsultimet me publikun dhe dëgjimet për buxhet (KAB)	3
3	Niveli i kthimit të përgjigjes për qasje n D.Z	4	3	Takimet publike të rregullta me qytetar (fshatra apo komunë)	5
4	Publikimi i planit të punës së Kryetarit	3	4	Organizimi i dëgjimeve publike dhe dëgjimet buxhetore (1 për 25,000 banorë -KAB)	5
5	Vizitat javore të Kryetarit/ës	3	5	Material përcjellës qytetarëve për dëgjimet publike dhe buxhetore (KAB)	3
6	Raporti i Kryetarit/es në Kuvend (raporti i punës 2 herë në vit)	3	6	Konsolidimi dh ekonsultimi i Bashkësive Lokale	3
7	Konkurs për punësim dhe kriteret ne ëeb faqe	3	7	Linjë direkte pa pages për qytetarët	2
8	Vendimet e Kryetarit të Komunës	5	8	Hapja e t dhënave statestikore OPEN DATA	3
9	Planet Zhvillimore të Komunës	4	9	Takimet me organizata të shoqërisë civile	3
10	Detajet Biografike të Kryetarit dhe drejtorëve (email, Nr kontaktues, biografi etj)	2	10	Listën e hollësishme të shërbimeve që i ofron insti-tucioni për publikun	4
11	Ueb-faqja në gjuhët tjera zyrtare (gjuhët në përdorim)	2	11	Rifreskimi i Faqës së Eëbookut	3
<b>PIKË GJITHSEJ</b>		<b>35</b>	<b>PIKË GJITHSEJ</b>		<b>35</b>

|||||

## ANEKS 2: TRANSPAROMETRI KOMUNAL (1)

MËNYRA E MATJES	TRANSPARENCA NË KUVENDIN E KOMUNËS	PRISHTINË	PRIZREN	GJAKOVË	GJILAN	GRAÇANICË	DEÇAN
Ueb-Faqe	Qasja në rendin e ditës	3	3	3	3	3	3
Fizikisht	Seancat e hapura për publikun	3	3	3	3	3	3
Fizikisht	Transmetimi i drejtëpërdrejt i seancave të Kuvendit	3	3	3	3	0	2
Ueb-Faqe	Qasja në procesverbale	1	0	3	3	2	2
Ueb-Faqe	Qasja në draftet e rregulloreve dhe planeve	3	2	1	2	2	2
Ueb-Faqe	Qasja në rregulloret dhe vendimet	3	2	3	3	3	2
Fizikisht	Komitetet e hapura për publikun	2	2	3	3	2	3
Fizikisht	Mbajtja e seancave të rregullta (10 brenda vitit)	2	3	3	3	2	3
Ueb-Faqe	Plani i punës së Kuvendit	3	3	0	3	0	0
Ueb-Faqe	Detajet biografike dhe email-adresat e Anëtarëve të Kuvendit	2	1	2	3	1	2
Ueb-Faqe	Plani i veprimtimit për Transparenc	2	3	2	3	3	2

MËNYRA E MATJES	TRANSPARENCA NË EKZEKUTIVIN E KOMUNËS	PRISHTINË	PRIZREN	GJAKOVË	GJILAN	GRAÇANICË	DEÇAN
Fizikisht	Zyrtarë për informim & Koordinatori. Për qasje në D.Z	3	3	3	3	3	3
Ueb-Faqe	Raporti gjashtëmuor i punës	2	1	2	2	0	0
KërkesëZyrt.	Niveli i kthimit të përgjigjes për qasje n D.Z	3	1	3	1	3	3
Ueb-Faqe	Publikimi i planit të punës së Kryetarit	0	0	3	3	0	0
Fizikisht	Vizitat javore të Kryetarit/ës	3	0	3	3	1	3
Fizikisht	Raporti i Kryetarit/es në Kuvend (raporti i punës 2 herë në vit)	0	0	3	3	0	0
Ueb-Faqe	Konkurs për punësim dhe kriteret ne ueb faqe	3	3	3	3	3	3
Ueb-Faqe	Vendimet e Kryetarit të Komunës	3	3	1	1	0	1
Ueb-Faqe	Planet Zhvillimore të Komunës	3	2	3	3	2	3
Ueb-Faqe	Detajet Biografike të Kryetarit dhe drejtorëve (email, Nr kontaktues, biografi etj)	3	2	3	3	1	3
Ueb-Faqe	Ueb-faqja në gjuhët tjera zyrtare (gjuhët në përdorim)	3	2	0	1	2	1

## ANEKS 3: TRANSPAROMETRI KOMUNAL (2)

MËNYRA E MATJES	TRANSPARENCA FINANCIARE	PRISHTINË	PRIZREN	GJAKOVË	GJILAN	GRAÇANICË	DEÇAN
Fizikisht/KërkesëZyrt.	Ndryshimet buxhetore të miratuara nga Kuvendi i Komunës	0	3	3	3	3	3
Ueb-Faqe	Borxhi publik komunal (borxh i kompanive)	2	0	1	0	0	0
Ueb-Faqe	Raporti i shpenzimeve tremujore	2	3	3	2	1	0
Ueb-Faqe	Raporti i Auditimit	3	3	3	0	0	0
Fizikisht	Diskutimet brenda afateve ligjore të shpenzimeve tre-mujore në Kuvend	1	2	2	3	2	2
KërkesëZyrt/Ueb-Faqe	Lista e pronave (zyrat, lokalet, etj) të marra me qira për komunën	3	3	3	3	0	3
Ueb-Faqe	Të hyrat vetanake të Komunës	2	3	2	2	3	0
Ueb-Faqe	Plani buxheti dhe kohëzgjatja e projekteve kapitale	3	2	2	3	3	2
Ueb-Faqe	Plani i Prokurimit	3	1	3	0	0	0
Ueb-Faqe.	Njoftimet për Kontratë dhe dhënie të Kontratës	3	3	3	1	0	1
KërkesëZyrt	Publikimi i Kontratave	3	2	3	0	3	3

MËNYRA E MATJES	TRANSPARENCA NË KONSULTIME ME PUBLIKUN	PRISHTINË	PRIZREN	GJAKOVË	GJILAN	GRAÇANICË	DEÇAN
Fizikisht/ Ueb-Faqe	Njoftimi on&offline forma tradicionale, gazeta, shpallje) për takime publike	3	3	3	3	2	3
KërkesëZyrt/Ueb-Faqe	Raport nga Konsultimet me publikun dhe dëgjimet për buxhet (KAB)	1	0	1	1	0	1
Fizikisht/Ueb-Faqe	Takimet publike të rregullta me qytetar (fishatra apo komunë)	3	0	3	3	3	3
Fizikisht/Ueb-Faqe	Organizimi i dëgjimeve publike dhe dëgjimet buxhetore (1 për 25,000 banorë -KAB)	3	3	3	3	3	3
Fizikisht/Ueb-Faqe	Material përcjellës qytetarëve për dëgjimet publike dhe buxhetore (KAB)	3	2	3	3	0	2
Fizikisht	Konsolidimi dh ekonsultimi i Bashkësive Lokale	0	2	3	2	2	3
Fizikisht	Linjë direkte pa pages për qytetarët	3	0	3	3	0	3
Ueb-Faqe	Hapja e të dhënave statestikore OPEN DATA	3	1	3	2	0	0
Fizikisht	Takimet me organizata të shoqërisë civile	3	1	3	2	1	1
Ueb-Faqe	Listën e hollësishme të shërbimeve që ofron institucioni për publikun	2	1	1	1	1	1
Ueb-Faqe	Rifreskimi i Faqës së Febookut	3	2	3	3	3	3

|||||

|||||



KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Me përkrahjen financiare të:



Ky publikim është pjesë e projektit **“Hapja e të dhënave në funksion të transparencës dhe zhvillimit lokal”**, zbatuar nga **Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)**, financuar nga **Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS)**.

Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.